



Politika ndëshkimore në rastet e posedimit të paligjshëm të armëve

Prill 2024



Politika ndëshkimore në rastet e posedimit të paligjshëm të armëve

Prill 2024

Pasqyra e përmbajtjes

1. Hyrje	1
2. Metodologjia	2
3. Korniza Ligjore	3
A. Standardet ndërkombëtare.....	3
B. Korniza ligjore e Kosovës	4
4. Analiza e rasteve	5
5. Përfundime	14
6. Rekomandime	15

1. Hyrje

Që nga viti 1999, mandati i seksionit për monitorimin e gjykimeve në kuadër të Misionit në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka qenë që të monitorojë sistemin e drejtësisë në Kosovë për sa i përket pajtueshmërisë me parimin e gjykimit të drejtë dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Raportet e monitorimit të gjykimeve bazohen në monitorimin e drejtpërdrejtë nga stafi i OSBE-së në gjykata në mbarë Kosovën, me fokus në çështjet sistemike që prekin sistemin e drejtësisë.

OSBE-ja ka raportuar më herët lidhur me praktikat ndëshkimore në Kosovë¹ çështje kjo që vazhdon të jetë me rëndësi të madhe meqë prekë të drejtat themelore, siç është e drejta për gjykim të drejtë. Ky raport fokusohet më konkretisht në çështjet sistemike që kanë të bëjnë me praktikat ndëshkimore në rastet e posedimit të paligjshëm të armëve, që dihet se është problem i përhapur në Kosovë. Për ilustrim, në vitin 2022, Policia e Kosovës ka regjistruar konfiskimin e 1473 armëve të poseduara ilegalisht, ndërsa vetëm në gjysmën e parë të vitit 2023 janë konfiskuar 636 armë.²

Ky raport nënvizon mangësitë për sa i përket konsistencës dhe arsytimit të vendimeve ndëshkimore për posedim të paligjshëm të armëve, të cilat mund të mos jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe kornizën ligjore përkatëse në Kosovë. Në veçanti, OSBE-ja ka monitoruar rastet kur gjykatat kanë bërë vlerësim joadekuat të rrethanave përkatëse lehtësuese ose rënduese gjatë shqiptimit të dënimit të të pandehurve dhe shpeshherë nuk kanë nxjerrë vendim të arsyetuar. Përveç kësaj, OSBE-ja ka vërejtur mospërputhje në dënimet e shqiptuara, gjë që ngre shqetësime se personat trajtohen ndryshe sipas ligjit në situata të ngjashme faktike. Ose, në të kundërtën, nuk merren parasysh rrethanat specifike në raste të ndryshme.

Qëllimi i këtij raporti është të propozojë rekomandime specifike për veprime korrigjuese që mund të kontribuojnë në rritjen e standardeve dhe konsistencës, duke përmirësuar kështu praktikat ndëshkimore.

1 OSBE, rishikimi i sistemit të drejtësisë penale në Kosovë (prill 2003 - tetor 2004) Krimi, paraburgimi dhe ndëshkimi (dhjetor 2004); OSBE, Vlerësimi joadekuat i rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga gjykatat (korrik 2010).

2 Policia e Kosovës, "Disa statistika për mbajtjen e armëve pa leje dhe aktivitetet policore në zbulimin dhe konfiskimin e tyre": <https://www.kosovopolice.com/en/disa-statistika-per-mbajtje-arme-pa-leje-dhe-aktivitetet-policore-ne-zbulimin-dhe-konfiskimin-e-tyre/> (qasur më 15 dhjetor 2023).

2. Metodologjia

Metodologjia e këtij raporti bazohet në:

- i. Analizën cilësore të të dhënave të mbledhura nga seancat dëgjimore të monitoruara nga OSBE-ja³ nga dhjetori 2020 deri në gusht 2023 (periudha raportuese), dhe të aktgjykimeve përkatëse; dhe
- ii. Hulumtimin në zyrë lidhur me standardet ndërkombëtare dhe ligjin e Kosovës.

Për qëllim të këtij raporti, OSBE-ja ka analizuar gjithsej 33 raste.⁴

Përmes kombinimit të analizave sasiore dhe cilësore, raporti paraqet të dhëna të zbërthyera mbi aspektet përkatëse që kanë të bëjnë me rastet e përfshira në këtë mostër.

3 Metodologjia e monitorimit të gjykimeve e përdorur nga monitoruesit e gjykimeve të OSBE-së bazohet në metodën dhe parimet e monitorimit të gjykimit të ODIHR-it të përshkruara në manualin e praktikuesve të ODIHR-it 2012 (*shih Zyrën e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), Manuali i Monitorimit të Gjykimeve: Manual Referues për Praktikuesit (botim i rishikuar, 2012): <https://www.osce.org/odihr/94216>* (qasur më 12 shtator 2023).

4 Janë analizuar 31 aktgjykime, OSBE-ja nuk ka pasur qasje në aktgjykimet me shkrim në dy nga rastet e monitoruara.

3. Korniza Ligjore

A. Standardet ndërkombëtare

E drejta për gjykim të drejtë garantohet me nenin 14 të *Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike* (KNDCP)⁵ dhe nenin 6 të *Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore* (KEDNJ)⁶ dhe e drejta në vendim të arsyetuar është një nga pjesët thelbësore të kësaj garancie themelore.⁷

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka konstatuar se “gjykatat dhe tribunalet duhet t’i deklarojnë në mënyrë adekuate arsyet mbi të cilat bazohen [vendimet]”,⁸ meqë vendim i arsyetuar është element thelbësor për të ushtruar të drejtën e ankimit në mënyrë kuptimplote.⁹ Neni 6 i KEDNJ-së nuk mund të kuptohet si kërkesë për të dhënë përgjigje të detajuar për çdo argument dhe shkalla e detyrimit ndryshon sipas natyrës së vendimit. Megjithatë, është me rëndësi që të trajtohen parashtrirat që shkojnë në thelb të çështjes.¹⁰

Është me rëndësi që mbrojtja e garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së të shtrihet në të gjitha fazat e procedurës penale, përfshirë në procesin e dënimit.¹¹ Këshilli i Evropës (KiE) në *Rekomandimin e tij nr. R(92)17 për Komitetin e Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me konsistencën në dënime*¹² gjithashtu ka theksuar se “gjykatat duhet, në përgjithësi, t’i deklarojnë arsyet konkrete për shqiptimin e dënimeve”.¹³ Për sa i përket konsistencës në shqiptimin e dënimeve, KiE rekomandon që “rastet e ngjashme duhet të trajtohen njësoj dhe rastet e ndryshme ndryshe, përderisa dallimet arsyetohen me kujdes”.¹⁴

Ndonëse nuk ekziston një kornizë e përgjithshme ligjore ndërkombëtare e zbatueshme në Kosovë për sa i përket posedimit të armëve nga personat privatë, duhet theksuar se Bashkimi Evropian kohët e fundit ka kodifikuar një kornizë që përcakton kushtet minimale për posedimin e armëve të zjarrit dhe municionit në

5 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, dhjetor 1966,

6 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nëntor 1950.

7 Udhëzuesi për nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, E drejta për gjykim të drejtë (aspekti penal), gusht 2022 (Udhëzuesi për nenin 6 të KEDNJ), paragrafët 185-190.

8 Shih p.sh. Moreira Ferreira kundër Portugalisë (nr. 2), korrik 2017.

9 Shih p.sh. Hadjianastassiou kundër Greqisë, dhjetor 1992.

10 Shih p.sh. Rita Hiro Balanie kundër Spanjës, 9 dhjetor 1994.

11 Udhëzuesi për nenin 6 të KEDNJ-së, gusht 2022, para.50.

12 Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr.R(92)17 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me konsistencën në dënime, tetor 1992 (Rekomandimi i KiE R(92)17).

13 Rekomandimi i KiE R(92)17, f. 4.

14 Këshilli i Evropës, “Konsistenca në shqiptimin e dënimeve: Rekomandimi për Shtetet Anëtare dhe Memorandumi Shpjegues.” *Forumi për të Drejtën Penale* 4.2 (1993): 355 – 392, f 366. Shih gjithashtu Rekomandimin e KiE R(92)17, f.1.

mënyrë specifike, duke përcaktuar kufizime për disa kategori të armëve.¹⁵ Këto dispozita, të cilat janë miratuar me synimin për t'i harmonizuar rregulloret në të gjitha shtetet anëtare, megjithatë mund të shërbejnë si parime udhëzuese për legjislacionin kombëtar.

B. Korniza ligjore e Kosovës

Të drejtat për gjykim të drejtë janë të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës.¹⁶ Për më tepër, neni 22 i Kushtetutës përcakton që të drejtat themelore të garantuara nga KNDCP-ja dhe KEDNJ-ja janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.

Kapitulli XXIX mbi "Veprat penale të armëve" i Kodit Penal të Kosovës (KPK) të vitit 2019 dhe Ligji i vitit 2015 për Armë¹⁷ krijojnë kornizën ligjore vendore për armët. Më konkretisht, neni 366(1) i KPK-së përkufizon veprën penale të "mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" (e njohur edhe si "posedimi i paligjshëm i armëve") dhe përcakton dënimet e zbatueshme.

Në vitin 2018, para hyrjes në fuqi të KPK-së të vitit 2019, Gjykata Supreme ka nxjerrë Udhëzuesin për politikën ndëshkimore i cili, edhe pse jo detyrues për nga natyra, synon të ofrojë sqarime dhe të adresojë pabarazitë në dënime. Në thelb, Udhëzuesi për politikën ndëshkimore ofron udhëzime të përgjithshme për dënimin dhe përdorimin e faktorëve rëndues dhe lehtësues të zbatueshëm për të gjitha veprat penale, duke përfshirë posedimin e paligjshëm të armëve.¹⁸ Megjithëse publikimi i Udhëzuesit për politikën ndëshkimore i ka paraprirë KPK-së aktuale (2019), duke iu referuar kështu Kodit Penal të mëparshëm (2013), në thelb dispozitat përkatëse zbatohen edhe për KPK-në e vitit 2019.

15 Direktiva (BE) 2021/555 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 mars 2023 për kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve.

16 Kushtetuta e Kosovës, qershor 2008.

17 Ligji nr. 05/L - 022 për Armë, 19 gusht 2015.

18 Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzuesi për politikën ndëshkimore, Botimi 1 (2018), fq 139-163.

4. Analiza e rasteve

Gjatë periudhës raportuese, OSBE-ja i ka monitoruar 33 raste në lidhje me akuzat për “Pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” siç përcaktohen në nenin 366(1) të KPK-së së vitit 2019.

Për sa i përket përfaqësimit gjinor dhe komuniteteve për 33 rastet e lartpërmendura, të gjitha, përveç një rasti kishin të bënin me të pandehur meshkuj (gjegjesisht, një grua dhe 32 burra) dhe vetëm dy raste përfshinin të pandehur nga komunitetet jo-shumicë (gjegjesisht, dy serbë dhe 31 shqiptarë).


Neni 113(40) i KPK-së dhe neni 3 i Ligjit për Armë i vitit 2015 përcaktojnë se çka konsiderohet armë për qëllimin e këtyre ligjeve:

Armët sipas nenit 113(40) të KPK 2019	Armët sipas nenit 3 të Ligjit 2015 nr. 05/L-022
Armë konsiderohen: 40.1. armët e zjarrit; 40.2. armët e koleksionit; 40.3. armët pneumatike (ajrore); 40.4. armët që përdoren për shpërndarjen e gazit irritues; 40.5. armët shpërthyes; 40.6. armët me shigjeta; 40.7. armët e ftohta; 40.8. armët për sinjalizim akustik dhe të dritës; 40.9. armët elektroskok; 40.10. armët me rrymë.	1. Sipas këtij ligji, armë konsiderohen: 1.1. armët e zjarrit; 1.2. armët e koleksionit; 1.3. armët pneumatike; 1.4. armët për përdorim të agjentëve kimik; 1.5. armët eksplozive (shpërthyes); 1.6. armët me hark, tojë (tetivë); 1.7. armët e ftohta; 1.8. armët për sinjalizim me dritë dhe akustik; 1.9. armët me elektroskok (paralizuesit elektrikë); dhe 1.10. armët e drejtuara nga energjia (ADE).

Tabela 1. Llojet e armëve sipas KPK-së të vitit 2019 dhe Ligjit nr. 05/L-022 të vitit 2015

Shumëllojshmëria e armëve e përshkruar në KPK-në e vitit 2019 dhe Ligjin për Armë të vitit 2015 reflektohet në llojet e armëve të hasura në rastet e monitoruara nga OSBE-ja. Veçanërisht, nga gjithsej 33 raste të posedimit të paligjshëm të armëve, 28 raste kishin të bënin me armë zjarri (p.sh. pistoletë, armë zjarri gjysmë automatike, pushkë gjuetie); një rast kishte të bënte vetëm me armë të ftohta (gjegjesisht, thika, shufra metalike dhe/ose shkopinj); një rast kishte të bënte me armë vetëm për përdorimin e gazit irritues shpërndarës (spërkatës piperi); dhe tri

raste përfshinin armë të ftohta dhe armë për përdorimin e gazit irritues shpërndarës.



Diagrami 1. Llojet e armëve në 33 rastet e posedimit të paligjshëm të armëve

Vlen të përmendet se korniza ligjore e Kosovës për veprat penale të lidhura me armët nuk bën dallime në dënime duke u bazuar në llojin e armës së poseduar si pjesë e veprës penale, dëmin e shkaktuar, ose shkallën e rrezikut që përbën arma në fjalë. Për më tepër, KPK-ja e vitit 2019 përcakton vetëm dënimin maksimal për “Mbajtjen në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” (neni 366) në formë të gjobës ose me burgim.¹⁹


Duke reaguar ndaj pabarazive shqetësuese të dënimeve të vërejtura në të kaluarën, Udhëzuesi për politikën ndëshkimore i Gjykatës Supreme i vitit 2018 ka paraqitur një sërë rekomandimesh që synojnë t’i kanalizojnë praktikatat ndëshkimore. Ato ofrojnë një udhëzues për llogaritjen e dënimeve duke u bazuar në rrethanat rënduese dhe lehtësuese, duke përfshirë përdorimin e disa masave lehtësuese të rëndësishme që parashihen në Kodin Penal.²⁰ Udhëzuesi për politikën ndëshkimore ka përfshirë një grafik që propozon një sërë dënimesh të mundshme me burgim bazuar në mënyrën se si zbatohen rrethanat lehtësuese dhe/ose rënduese në një rast të caktuar. Megjithatë, duke pasur parasysh se Udhëzuesi për politikën ndëshkimore është i heshtur për sa u përket dënimeve që përbëhen nga gjobat, gjykatat e kanë diskrecionin e plotë për të shqiptuar dënimin e duhur monetar në një rast të caktuar – përderisa është brenda kufijve të paraparë nga neni 72(1.1.7) dhe (1.1.8) i KPK-së:

19 Paragrafi 2 i nenit 366 përmban një përjashtim nga kjo pasi parasheh një dënim minimal prej dy vitesh burgim nëse vepra përfshin më shumë se katër (4) armë, ose më shumë se katërqind (400) fishekë.

20 Neni 71, KPK i vitit 2019 (neni 75, KPK i vitit 2013).

“1.7 nëse për veprën penale nuk është paraparë masa më e ulët e dënimit, atëherë mund të shqiptohet dënimi me gjobë në vend të dënimit me burgim;
1.8. nëse për veprën penale nuk është paraparë shuma më e ulët e gjobës, gjopa mund të zbutet deri në njëqind (100) euro.”

Nga 33 raste të posedimit të paligjshëm të armëve të monitoruara nga OSBE-ja, 31 raste kanë rezultuar me gjobë (nga 200 deri në 2000 euro), ndërsa në dy rastegjykata i ka dënuar të pandehurit me burgim me kusht (90 ditë, përkatësisht gjashtë muaj).²¹ Në 31 rastet që kanë rezultuar me gjobë, dënimi më i zakonshëm ishte 400 euro (në nëntë raste), pasuar nga 500 euro (në tetë raste). Dënimi më i ulët ishte 200 euro (në një rast), ndërsa gjopa më e rëndë prej 2000 euro është shqiptuar në një rast.



Diagrami 2. Shpeshtësia dhe sasia e dënimit në 31 rastet që konsistojnë në gjobë

Është me interes të theksohet se në të 33 rastet e monitoruara nga OSBE-ja, të pandehurit kanë pranuar fajësinë për akuzën e posedimit të paligjshëm të armëve. Në krahasim me raportin e saj të vitit 2016 mbi *Zbatimin e Kodit të Ri të Procedurës Penale të Kosovës*, OSBE-ja ka vërejtur se pranimet e fajësisë ishin

²¹ Këto përlllogaritje bazohen vetëm në dënimet e shqiptuara për posedim të paligjshëm të armës (neni 366 KPK) dhe nuk përfshijnë dënimin e shqiptuar për veprat penale të ndërlidhura në të njëjtin rast.

regjistruar në 25 për qind të seancave të monitoruara për qëllim të raportit – duke përfshirë të gjitha llojet e krimeve.²²

Ky përdorim i lartë i marrëveshjes së pranimit të fajësisë mund të shpjegohet nga disa faktorë, duke përfshirë llojin e veprës penale (d.m.th., kur provat rrjedhin nga një bastisje dhe sekuestrim) ose nxitja e lartë e një dënimi më të butë duke pasur parasysh se pranimi i fajësisë është konsideruar si një faktor kryesor lehtësues në çdo rast të monitoruar. Megjithatë, kjo mund të jetë edhe tregues simptomatik i një problemi më të gjerë dhe mund të ngrejë shqetësime për sa i përket, mes tjerash, përfaqësimit joefikas, marrëveshjeve për pranimin e fajësisë në rastet që përfshijnë një të akuzuar të papërfaqësuar, vlerësimin joadekuat nga gjyqtarët të kushteve procedurale të pranimit të fajësisë,²³ ku të gjitha këto do të kërkonin një analizë më të thellë.

Nga 33 rastet e armëmbajtjes pa leje të monitoruara nga OSBE-ja, 15 përfshinin dënime për vepra të njëkohshme. Më konkretisht, nëntë për përdorim arme ose mjetit të rrezikshëm;²⁴ një për shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm;²⁵ një për gjueti të kundërligjshme;²⁶ dy për posedim të paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge;²⁷ një për tentativë vrasje;²⁸ dhe një për tentativë për pjesëmarrje në një turmë që kryen një veprë penale dhe huliganizëm.²⁹

22 OSBE, Zbatimi i Kodit të Ri të Procedurës Penale të Kosovës (qershor 2016), f. 25.

23 Shih nenin 242 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Në veçanti, vlerësimi i gjyqtarëve nëse i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e marrëveshjes së pranimit të fajësisë.

24 Neni 367(1) KPK.

25 Neni 356(1) KPK.


26 Neni 350(2) KPK.

27 Neni 269(1) KPK.

28 Neni 172 në kombinim me nenin 28 të KPK.

29 Neni 404(1-3) në kombinim me nenin 28 KPK.

Politika ndëshkimore në rastet e posedimit të paligjshëm të armëve



Diagrami 3. Veprat e njëkohshme në rastet e armëmbajtjes pa leje (Neni 366(1) KPK)

Në bazë të rasteve dhe aktgjykimeve përkatëse me shkrim të konsultuara për këtë analizë, OSBE-ja ka identifikuar dy mangësi kryesore në lidhje me praktikën e politikës ndëshkimore në rastet e armëmbajtjes pa leje: a) përdorimi/vlerësimi joadekuat i rrethanave rënduese dhe lehtësuese; dhe b) mungesë të konsistencës në dënime.

A. Përdorimi/vlerësimi joadekuat i rrethanave rënduese dhe lehtësuese

OSBE-ja vëren se në disa raste gjyqtarët nuk e kuptuan mirë se si rrethanat e ndryshme duhet të ndikojnë në vendimin për dënim, nuk e individualizuan vlerësimin e tyre të rrethanave që lidhen me një rast ose veprë të caktuar dhe në përgjithësi nuk arritën të japin vendime të kuptueshme dhe të arsyetuara.

Për shembull, në një rast në rajonin e Gjilanit, një burrë u dënua në mars të vitit 2022 për armëmbajtje pa leje (një shkop metalik, thika dhe pistoletë me shkrepëse) dhe për posedim të paautorizuar të narkotikëve (Neni 269(1) i KPK-së). I pandehuri u dënua me 90 ditë burgim me kusht për një vit (armëmbajtje) dhe me 100 ditë burgim zëvendësuar me 700 euro gjobë (posedim narkotikësh). Në aktgjykimin me shkrim gjykata nuk ka bërë dallim ndërmjet dy veprave kur ka dhënë arsyetimin e saj për rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Në një rast në rajonin e Mitrovicës, një burrë u dënua në qershor të vitit 2022 për armëmbajtje pa leje (spruc piperi) dhe u dënua me

gjobë prej 400 euro. Në këtë rast gjykata ka zbatuar elementet e dashjes kriminale si faktorë rëndues në përcaktimin e dënimit përkatës, gjegjësisht që i pandehuri ka qenë në dijeni se veprimi i tij (posedimi i armës) është i ndaluar përderisa ka pasur qëllim ta ndër marrë veprimin. Kjo tregon një keqkuptim të qartë të konceptit të rrethanave rënduese, dhe një huti midis elementeve të *mens rea* të nevojshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit dhe faktorëve rëndues (siç është shkalla e përgjegjësisë penale)³⁰ që do duhej të merreshin parasysh në shqiptimin e dënimit.

Në shkurt të vitit 2023, në një rast tjetër në rajonin e Mitrovicës, një burrë u dënua për herë të dytë për veprën penale të armëmbajtjes pa leje (një pistoletë dhe nëntë fishekë). Në këtë rast, gjykata e dënoi të pandehurin me gjobë prej 600 eurosh. Në të kaluarën (në tetor të vitit 2022), për një vepër të ngjashme (dhe të veçantë), ai ishte dënua me gjobë prej 450 eurosh. Edhe pse gjykata listoi faktorët lehtësues dhe rëndues, ajo nuk vlerësoi se si këta faktorë kanë ndikuar në dënim. Vlen të përmendet se rrethana rënduese se i pandehuri ishte recidivist në një rast të ngjashëm thjesht u referua si “i dënua më parë për një vepër penale”. Gjykata nuk analizoi se “autori [kishte] kryer më parë një vepër penale të llojit të njëjtë me veprën e fundit penale”.³¹

Në maj të vitit 2023, në një rast në rajonin e Pejës, një burrë u dënua dhe iu shqiptua gjoba prej 1000 euro për armëmbajtje pa leje (pistoletë) dhe katër vjet burgim për vrasje në tentativë (neni 172 (në ndërlidhje me nenin 28) KPK). Në aktgjykimin me shkrim gjykata ka dhënë arsytim të pamjaftueshëm për sa i përket vlerësimit të rrethanave lehtësuese/rënduese, duke listuar kështu vetëm faktorët që janë marrë parasysh por pa dhënë fare shpjegim se si secili faktor ka ndikuar në dënim. Për më tepër, nga aktgjykimi del se gjykata nuk i ka marrë parasysh të gjithë faktorët lehtësues/rëndues të propozuar nga palët apo nuk ka dhënë arsytim të mjaftueshëm, duke mos dhënë fare shpjegim nëse kanë konsideruar se këta faktorë ishin të

30 Shih Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzimet për politikën ndëshkimore, botimi i parë (2018), fq. 38-39.

31 Siç është përkrahur me nenin 69(4) të KPK.

parëndësishëm, apo kanë qenë të rëndësishëm por nuk kanë pasur fare peshë.

Për më tepër, në të paktën tetë raste të armëmbajtjes pa leje, OSBE-ja vuri në dukje se aktgjykimet me shkrim e interpretonin posedimin e paligjshëm të një arme ose si “lloj i veprës penale të kohëve të fundit” ose si “më i shpeshtë në Kosovë” dhe e përdorën këtë në mënyrë të parregullt si rrethanë rënduese – që bie ndesh me parimin se vendimi për dënim duhet të mbështetet në “rrethanat individuale të rastit dhe situatën personale të kryerësit”.³² Është interesant fakti se në rastet ku këta faktorë janë konsideruar si rrethanë rënduese, dënimi mesatar nuk ishte më i rëndë se dënimi mesatar në rastet korresponduese ku nuk janë konsideruar të tilla.

Ndryshe, shembuj pozitivë janë dy raste të veçanta nga rajoni i Gjakovës dhe ai i Ferizajt, ku të pandehurit ishin dënuar në shkurt, përkatësisht më 8 gusht 2022 për armëmbajtje pa leje. Për dallim nga shembulli i mëparshëm, aktgjykimet e shkruara e konsideruan me të drejtë si rrethanë rënduese faktin që të dy të pandehurit ishin dënuar më parë për një vepër të ngjashme në një rast tjetër.

Vlen të përmendet se Udhëzuesi për politikën ndëshkimore i vitit 2018 përfshin një udhërrëfyes të hollësishëm të propozuar për gjykatat të çdo hapi për vlerësim të rrethanave lehtësuese dhe rënduese dhe tregon të gjithë informacionin përkatës që duhet të përfshihet në vendimet e arsyetuara të gjykatave. Është më se e qartë nga rastet studimore të mësipërme se disa gjykata, për fat të keq, nuk e aplikojnë qasjen e sugjeruar të Gjykatës Supreme e cila do të favorizonte shkallë më të lartë të konsistencës në praktikën e politikës ndëshkimore dhe do të siguronte përmbushje të standardeve të të drejtës në gjykim të drejtë.

B. Mungesa e konsistencës në shqiptim të dënimit³³

Mangësia e dytë kyçe që është vërejtur nga OSBE-ja ishte mungesa e dukshme e konsistencës në dënimet e shqiptuara. Ashtu siç është parim themelor i drejtësisë konsistenca në shqiptimin e dënimit në raste të ngjashme, e tillë është edhe nevoja për t’i marrë parasysh rrethanat e veçanta në raste të ndryshme për të shmangur “disproporcionin ndërmjet rëndesës së veprës dhe dënimit”.³⁴ OSBE-ja

³² Rekomandimi i KiE (92)17, f. 1.

³³ Për qëllime të saktësisë, kjo pjesë mbështetet në një analizë krahasuese të rasteve që përfshijnë vetëm një dënim për armëmbajtje pa leje, d.m.th., nuk përfshin rastet me vepra penale të njëkohshme.

³⁴ Rekomandimi i KiE R(92)17, f.2.

thekson se moslogaritja e rrethanave të veçanta bazuar në llojin e armës dhe shkallën e dëmtimit që përbën mund të çojë në dënime të ngjashme përkundër dallimeve në situata të veçanta.

Për shembull, në gusht të vitit 2022, një gjykatë nga rajoni i Ferizajt e shpalli fajtor të pandehurin për armëmbajtje pa leje (një pistoletë, një karikator dhe tre gëzhoja) në kundërshtim me Ligjin nr. 5/L-022 dhe të njëjtit i shqiptoi gjobë prej 1000 euro. Ndërsa në shtator të vitit 2022, një gjykatë në rajonin e Mitrovicës e shpalli fajtor të pandehurin për armëmbajtje pa leje (një armë zjarri automatike dhe tre karikatorë si dhe një armë zjarri gjysmë-automatike) dhe të njëjtit i shqiptoi gjobë prej 1000 euro. Dy të pandehurit më sipër morën dënime identike (1000 euro), ndonëse rasti i fundit ishte padyshim më i rëndë meqë përfshinte armë dukshëm më të rrezikshme.

Në vijim janë disa shembuj të tjerë të dënimeve të ngjashme për vepra të rëndësës së ndryshme (bazuar në nivelin e rrezikut që paraqet arma).

Më 2022 dhe 2023, një gjykatë në rajonin e Mitrovicës dënoi katër të pandehur në raste të ndryshme me gjoba prej 400 euro, për posedim të paligjshëm të mjeteve si në vijim:

- Një të pandehuri për posedim të një arme për përdorim të shpërndarjes së gazit irritues (një spruc piperi) dhe një armë të ftohtë (një shkop metalik);
- Një të pandehuri për posedim të një arme për përdorim të shpërndarjes së gazit irritues (spruc piperi) dhe katër armë të ftohta (tre shkopinj druri dhe një shkop bejsbolli);
- Një të pandehuri për posedim të një pistolette dhe një karikator me katër fishekë; dhe
- Një të pandehuri për posedim të një pistolette gazi dhe një karikator me pesë fishekë.

Faktorët lehtësues dhe rëndues që janë marrë parasysh për përcaktimin e dënimit ishin të ngjashëm në të katër këto rast dhe përfshinin mungesën e dënimeve paraprake, pranimin e fajësisë, keqardhjen dhe premtimin për të mos përsëritur veprën si rrethana lehtësuese, si dhe dashjen kriminale dhe përgjegjësinë, si rrethana rënduese. Thënë thjeshtë, nga aktgjykimet duket se nuk ka pasur

Politika ndëshkimore në rastet e posedimit të paligjshëm të armëve

dallime të dukshme në rrethanat e konsideruara që do të shpjegojnë këtë homogjenitet në shqiptimin e dënimeve në rastet që përfshijnë armë që paraqesin nivele kaq të ndryshme rreziku.

Kur flasim për parandalimin e mospërputhjes së tillë në shqiptimin e dënimit në rastet e armëmbajtjes, juridiksionet e tjera kanë krijuar vepra apo kategori të dallueshme sipas llojit të armës.

Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar, Këshilli për Politikën Ndëshkimore bën dallimin midis “armëve të zjarrit” dhe “thikave dhe armëve sulmuese”. Për të parën, ka udhëzim për politikën ndëshkimore për rastet e mbajtjes së armëve të zjarrit pa leje/certifikatë. Kjo përcakton fajësinë fillestare bazuar në llojin e armës së zjarrit, përkatësisht Llojin 1 (armët e zjarrit ose armët e gjahut të cilat janë shkurtuar ose konvertuar, përkatësisht, sipas kuptimit të pjesës 4(4) të Ligjit për Armët e Zjarrit të vitit 1968), Lloji 2 (të gjitha armët e tjera të zjarrit ose pushkë gjahu dhe/ose municione), dhe Lloji 3 (sasi shumë e vogël municioni). Kjo dallon nga sistemi i llogaritjes së dënimit për armët e tjera.

Tutje, Kodi i Sigurisë së Brendshme në Francë përcakton katër kategori të dallueshme të armëve të zjarrit, Lloji A (materiale dhe armë lufte), Lloji B (pistoleta, pushkë, pushkë gjysmë-automatike), Lloji C (pushkë gjuetie) dhe Lloji D (armë të ftohta, spruc piperi, imitimet e armëve). Posedimi i paligjshëm i armëve dënohet sipas kategorisë së cilës i përket arma: për Llojet A dhe B (pesë vjet burgim dhe 75.000 euro gjobë sipas nenit 222-52 të Kodit Penal 2016); për Llojin C (dy vjet burgim dhe 30.000 euro gjobë sipas nenit L317-4-1 të Kodit të Sigurisë së Brendshme 2019); për Llojin D (një vit burgim dhe 15 000 euro gjobë sipas nenit L317-8 të Kodit të Sigurisë së Brendshme 2019).

Përmbledhtazi, armët klasifikohen në kategori ose lloje bazuar në natyrën e armës dhe shkallën e rrezikut që paraqesin. Rrjedhimisht, dënimi përkatës llogaritet rrethanat e veçanta që lidhen me llojin e armës së përfshirë në vepër penale.

5. Përfundime

OSBE-ja ka ngritur edhe më parë shqetësime rreth praktikave të politikës ndëshkimore në Kosovë dhe monitorimi i fundit tregon se ende ka çështje për sa i përket politikës ndëshkimore në rastet e posedimit të paautorizuar të armëve (Neni 366 (1) KPK).

Udhëzuesi për politikën ndëshkimore i vitit 2018 përfshiu rekomandime relevante që kishin për qëllim harmonizimin e praktikave ndëshkimore, ofrimin e udhëzimeve të veçanta për dënime bazuar në kufijtë e dënimit të përcaktuar në KPK, si dhe theksojnë nevojën për arsyetim adekuat. Megjithatë, në praktikë, OSBE-ja ende ka vërejtur një numër rastesh ku gjykatat nuk kanë realizuar vlerësim të duhur të rrethanave rënduese dhe lehtësuese dhe/ose nuk kanë dhënë vendime të arsyetuara në mënyrë adekuate. Gjithashtu, praktikat ndëshkimore kanë shfaqur mungesë të dallimit në vepër (dhe dënimin përkatës) bazuar në llojin e armës dhe shkallën e dëmtimit të paraqitur nga e njëjta, duke çuar në mospërputhje të qarta në politikën ndëshkimore në gjykatat e Kosovës.

6. Rekomandime

Duke pasur parasysh gjetjet e lartpërmendura, OSBE-ja propozon rekomandimet e mëposhtme për të rritur standardet dhe konsistencën në politikën ndëshkimore në rastet e armëmbajtjes pa leje në Kosovë:

Për Akademinë e Drejtësisë së Kosovës:

- Të shqyrtohet ofrimi i trajnimeve të përshtatura enkas për gjyqtarët dhe prokurorët për arsyetimin dhe shkrimin ligjor, veçanërisht lidhur me vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese në shqiptimin e dënimit në veprat penale të lidhura me armët.

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës:

- Të shqyrtohet krijimi i një forumi të diskutimit mes gjyqtarëve nga Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme për të promovuar vendime unifikuese të rasteve që mund t'i shërbejnë si udhëzim për gjykatat më të ulëta.

Për gjyqtarët në Kosovë:

- Të individualizohen vlerësimet e faktorëve rëndues dhe/ose lehtësues në një rast të caktuar, duke i kushtuar vëmendje të veçantë rrethanave përkatëse që janë specifike për veprat penale të lidhura me armët.
- Të sigurohet justifikim i duhur dhe arsyetim i hollësishëm për sa i përket përcaktimit të dënimit, duke përfshirë të gjithë informacionin relevant siç propozohet në Udhëzuesin për politikën ndëshkimore të vitit 2018.

Për Gjykatën Supreme të Kosovës:

- Të shqyrtohet plotësimi i Udhëzuesit për politikën ndëshkimore të vitit 2018 për sa i përket veprave të dënueshme me gjobë. Për politikën ndëshkimore në rastet e armëmbajtjes pa leje, të jepen sqarime shtesë për diferencimin e dënimeve me fokus në llojin e armës dhe shkallën e rrezikut.

Për Ministrinë e Drejtësisë:

- Të shqyrtohet iniciimi i ndryshim-plotësimit legjislativ (p.sh., ndryshim-plotësimit të kodit penal) për të parashikuar dënime më të dallueshme dhe specifike për llojet e ndryshme të armëve duke e përqendruar shqiptimin e dënimit në rrezikun e paraqitur nga një armë e caktuar.

